



**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

---

**RREGULLORE**

**PËR KUSHTET E AUTORIZIMIT TË KUJDESTARIT TË LETRAVE ME  
VLERË TË QEVERISË**

*Miratuar me vendimin e Bordit nr.21, datë 26.03.2009*

*Ndryshuar me vendimin e Bordit nr.79, datë 28.08.2009*

*Ndryshuar me vendimin e bordit nr. 29, date 19.03.2010*

Kjo Rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të nenit 14 pika 3, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” dhe të nenit 72 paragrafi i fundit të Ligjit nr.9879 datë 21.2.2008 “Për Titujt”.

**KREU I  
TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1  
Objekti**

Kjo Rregullore ka për objekt përcaktimin e kushteve të kryerjes së transaksioneve që lidhen me kujdestarinë e letrave me vlerë të Qeverisë dhe mënyrës së autorizimit të bankave për kryerjen e kësaj veprimtarie.

**Neni 2  
Kujdestari i letrave me vlerë të Qeverisë**

Kujdestari i letrave me vlerë të Qeverisë është banka e autorizuar për kryerjen e shërbimit të kujdestarisë të bonove të thesarit dhe obligacioneve shtetërore. Çdo bankë e autorizuar, me vendim të Bordit të AMF-së mund të kryejë shërbimin e kujdestarisë.

**Neni 3**

Kujdestaria e lidhur me transaksionet e letrave me vlerë, e ofruar nga bankat, organizohet si strukturë më vete, aktiviteti i të cilës nga ana operationale dhe drejtuese, ndahet në mënyrë të dukshme nga aktiviteti kryesor si bankë.

## **Neni 4**

### **Funksionet e Kujdestarit të letrave me vlerë të Qeverisë**

Kujdestari i letrave me vlerë të Qeverisë ka si funksion:

- a) mbajtjen dhe ruajtjen e letrave me vlerë të Qeverisë për llogari të klientëve të vet, në mënyrë të tillë që të sigurohen në çdo kohë të dhëna të plota në lidhje me pronësinë mbi letrat me vlerë të Qeverisë dhe kufizimeve të të drejtave të pronësisë mbi këto letra,
- b) raportimin dhe pagesën e interesit të fituar nga bonot e thesarit dhe obligacionet shtetërore për klientët e vet,
- c) të tjera funksione, që kanë lidhje me funksionin si kujdestar.

Kujdestari ka për detyrë:

- a) organizimin e mënyrës së mbajtjes së pronësisë së letrave me vlerë të Qeverisë,
- b) lidhjen e kontratave me klientët e vet për shërbimet e kujdestarisë,
- c) sigurimin e konfidencialitetit të të dhënave për letrat me vlerë të Qeverisë në emër të klientëve të vet, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga dispozitat ligjore në fuqi.

## **KREU II**

### **AUTORIZIMI I BANKËS PËR VEPRIMTARINË E KUJDESTARISË**

#### **Neni 5**

##### **Kërkesa**

Banka që kërkon të kryejë veprimtari në lidhje me kujdestarinë e letrave me vlerë të Qeverisë i drejtohet AMF me kërkesë me shkrim për të vepruar si kujdestar i letrave me vlerë të Qeverisë.

#### **Neni 6**

##### **Kushtet për të vepruar si kujdestar i letrave me vlerë të Qeverisë**

Banka e autorizuar për të vepruar si kujdestar i letrave me vlerë të Qeverisë duhet të plotësojë këto kushte:

1. Të jetë licencuar nga Banka e Shqipërisë për kryerje veprimtarie si kujdestar.
2. Të ketë të instaluar një sistem që siguron mbajtjen dhe ruajtjen e letrave me vlerë të Qeverisë për llogari të klientëve të vet.
  - a) Sistemi i mbajtjes dhe ruajtjes së letrave me vlerë të Qeverisë duhet të jetë i tillë që të sigurojë evidencë historike të informacionit mbi klientët, pa kryer ndërhyrje në të duke parandaluar mundësitë për abuzime, dëmtime, humbje etj;
  - b) Sistemi i regjistrimit të jetë i saktë dhe i sigurtë lidhur me të dhënat identifikuese të klientit (të përmbaje emrin, atësinë dhe mbiemrin e individit);

- c) Sistemi duhet të përditësojë menjëherë pas çdo transaksioni të dhënat dhe të evidentojë në çdo kohë të dhëna mbi zotëruesin e fundit të letrës me vlerë;
  - d) Sistemi të jetë i tillë që të pasqyrojë saktë dhe në kohë llogarinë e klientit në rastin e procedurave të pengut dhe të kolateralit;
  - e) Të sigurojë realizimin e back-up të bazes të të dhënave me teknologji bashkëkohore në 3 kopje identike;
  - f) Të rinovojë pajisjet kompjuterike dhe softet e tyre si një domosdoshmëri për të rritur cilësinë dhe shpejtesinë e shërbimeve në stadin aktual dhe në të ardhmen;
  - g) Të sigurojë informimin e plotë dhe të saktë të investitoreve lidhur me transaksionet dhe investimet e kryera;
  - h) Sistemi duhet të jetë i tillë që të sigurojë tregtimin me lehtësi të letrave me vlerë të Qeverisë në çdo sportel, të çdo bankë të nivelit të dytë të licencuar për aktivitetin e tregtimit të letrave me vlerë të Qeverisë.
3. Të ruajë konfidencialitetin e të dhënave për çdo individ.
4. Hartimi i Rregullave mbi bazën e të cilave realizohen marrëdhëniet e bankës me klientët, duke përcaktuar dokumentat që duhet të paraqesë klienti, mënyra e informimit për llogarinë e tij, lloji i dokumentit do t'i jepet atij për të vërtetuar pronësinë e tij mbi letrat me vlerë, një lloj kontrate tip në të cilën të sanksionohen marrëdhëniet midis palëve.

## **Neni 7**

### **Dokumentacioni që shoqëron kërkesën**

Plotesimi i kërkesave të përcaktuara në nenin 6 të kësaj rregulloreje duhet të vërtetohet nga dokumentacioni që shoqëron kërkesën drejtuar Autoritetit, si më poshtë:

- 1. licencë për ushtrim veprimtarie si bankë, lëshuar nga Banka Qëndrore, së bashku me aneksin shoqërues ku të jetë përfshirë edhe veprimtaria si kujdestar;
- 2. të dhëna në lidhje me drejtuesin e strukturës dhe eksperiencën e punës së tij;
- 3. të dhëna të detajuara për sistemin, pajisjet dhe hapesirat që do të përdoren për organizimin dhe administrimin e veprimtarisë së kujdestarisë;
- 4. Rregullat e Brendshme të funksionimit në të cilat bëjnë pjesë:
  - a) rregulla mbi mënyrën e organizimit të strukturës së kujdestarit;
  - b) rregulla në lidhje me procedurat e transferimit të pronësisë mbi leterën me vlerë;
  - c) rregulla mbi marrëdhëniet e bankës me klientet,
  - d) rregulla në lidhje me dhënien e informacionit dhe ruajtjen e konfidencialitetit;
  - e) rregulla në lidhje me procedurat dhe masat, në rast të pezullimit ose mbylljes së veprimtarisë së kujdestarisë, me vendim të organeve drejtuese apo me vendim të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare;
- 5. Dokumenta të tjera shtesë që mund të kërkojnë nga Autoriteti. Dokumentacioni duhet të paraqitet në origjinal ose fotokopje e noterizuar .

Përveç rregullave të parashikuara në pikën 4 të këtij neni, Kujdestari mund të hartojë rregulla të tjera që mund të gjykohen nga ai si të nevojshme apo të domosdoshme për ushtrimin e veprimtarisë.

**Neni 8**  
**Shqyrtimi i praktikës nga Autoriteti**

Autoriteti shqyrtton kërkesën dhe dokumentat shoqëruese dhe merr vendim brenda 60 ditësh që nga paraqitja e plotë e dokumentacionit.

Në shqyrtimin e dokumentacionit të mësipërm Drejtoria e Licencim Monitorimit bashkëpunon me Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit.

**Neni 9**  
**Detyrimi për të informuar kur ka ndryshime në dokumentacion**

Banka e autorizuar për të vepruar si Kujdestar i letrave me vlerë të Qeverisë, i paraqet Autoritetit informacion të plotë në lidhje me ndryshimet e ndodhura në të dhënat e paraqitura në momentin e vendimit për kryerje të veprimtarisë së kujdestarisë. Ky informacion i paraqitet Autoritetit brenda një muaji nga ndodhja e ndryshimit së bashku me arsyet të cilat çuan në këtë ndryshim.

**Neni 10**  
**E drejta për t'u informuar dhe për të kërkuar informacion**

Kujdestari i paraqet Autoritetit raporte mujore mbi mbarëvajtjen e aktivitetit të tij të firmosur nga Drejtuesi i strukturës. Ky raport duhet të paraqitet brenda 1 jave nga mbarimi i muajit për të cilin raportohet.

Autoriteti, në çdo rast mund t'i kërkojë kujdestarit informacion të përgjithshëm ose të dhëna për çështje të veçanta të lidhura me aktivitetin e tij.

**KREU III DISPOZITA**  
**TE FUNDIT**

**Neni 11**  
**Pagesat ndaj Autoritetit**

**(shfuqizuar)**

**Neni 12**  
**Dispozitë tranzitore**

Brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregullore të gjitha bankat e licencuara si regjistruar të letrave me vlerë të Qeverisë duhet të paraqesin kërkesën dhe dokumentacionin përkatës në Autoritet për pajisjen me autorizim për të vepruar si kujdestar i letrave me vlerë të Qeverisë.

**Neni 13**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi, në ditën e miratimit të saj nga Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

**Elisabeta GJONI**  
**KRYETAR**